



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr _____prot

Tiranë më _____, _____.2024

VENDIM

Nr. 342, datë 09.07.2024

PËR

**VERIFIKIMIN E PLOTËSIMIT NGA KANDIDATI Z. {...}
TË KRITEREVE LIGJORE TË KANDIDIMIT PËR NGRITJEN NË DETYRË
NË GJYKATËN E POSAÇME TË SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN
DHE KRIMIN E ORGANIZUAR, PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLURA
ME VENDIMIN NR. 247 DATË 02.05.2024 TË KËSHILLIT TË LARTË
GJYQËSOR DHE VIJIMIN E PROCEDURËS SË VERIFIKIMIT PËR KRITERET
E TJERA LIGJORE TË KANDIDIMIT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 4 të nenit 135, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në shkronjën “a” të pikës 2 dhe në pikën 3 të nenit 47, në pikën 7 të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, i ndryshuar, në pikën 9, të Vendimit të tij nr. 247, datë 02.05.2024; “Hapjen e procedurës së ngritjes në detyrë të gjyqtarit në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori i tij, z. Klodian Kurushi,

VENDOSI:

1. Verifikimin e plotësimit nga kandidati z. {...}, në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallura me Vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 247 datë 02.05.2024, të kriterëve të “përvojës profesionale minimale”, të “dhënies së pëlqimit (ai edhe familjarët e afërm) për kontrollin periodik të llogarive bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të “mospasjes masë disiplinore në fuqi” dhe të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”.
2. Vijimin e procedurës së verifikimit të kandidatit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit në procedurat e ngritjes në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për

Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 247 datë 02.05.2024.

3. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR